



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. 158, datë 2.3.2016

**PËR
NJË SHITESË NË VENDIMI NR. 668, DATË 7. 8.2013 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN ME USHQIM TË USHTARAKËVE TË FORCAVE
TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËR DISA
NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 524, DATË 30.7.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MASËN DHE MËNYRËN E KOMPENSIMIT TË QIRASË SË
BANESËS DHE TË USHQIMIT TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 21, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 668, datë 7.8.2013 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me ushqim të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 524, datë 30.7.2004 të Këshillit të Ministrave “Për masën dhe mënyrën e kompensimit të qirasë së banesës dhe të ushqimit të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, të bëhet kjo shtesë:
 - a. Në pikën 1, pas fjalës “...fushimi...”, të shtohet togfjalëshi “...ose kur kryejnë kurse institucionale dhe funksionale të Forcave të Armatosura...”.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.
3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren Zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I MBROJTJES

MIMI KODHELI